



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSPEKTORATI SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL
GRUPI I PUNËS PËR INTEGRITETIN

Nr. 6432 prot.

Tiranë, më 14.08.2026

VLERËSIMI I RISKUT TË INTEGRITETIT NË ISHTI

2026

Raport mbi Risqet e Integritetit dhe Masat për Trajtimin e Tyre në ISHTI

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vlerësimi i Riskut të Integritetit (VRI) në Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), synon të evidentojë dhe vlerësojë faktorët që mund të cenojnë integritetin institucional, objektivitetin dhe paanshmërinë në ushtrimin e funksioneve, ligjshmërinë e vendimmarrjes, transparencën, efektivitetin e proceseve të punës dhe besueshmërinë e institucionit.

Vlerësimi përfshin fushat kryesore të veprimtarisë së ISHTI-t, si çështjet juridike dhe prokurimet publike, menaxhimin financiar dhe buxhetor, trajtimin e aksidenteve dhe mbikëqyrjen, analizën dhe monitorimin e veprimtarisë inspektuese, informimin publik dhe koordinimin ndërinstitucional, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.

Në tërësi janë evidentuar **61 risqe të integritetit**, të cilat lidhen me procese dhe veprimtari të ndryshme të institucionit. Sipas nivelit të vlerësimit, **21 risqe klasifikohen me nivel të lartë, 34 me nivel të moderuar dhe 6 me nivel të ulët**. Këto rezultate evidentojnë nevojën për një qasje të vazhdueshme dhe të koordinuar në parandalimin, kontrollin dhe menaxhimin e risqeve të integritetit.

Ndër risqet kryesore të evidentuara në nivel institucional përfshihen ato që lidhen me **ndryshimet dhe zbatimin e kuadrit ligjor e rregullator, konfliktin e interesit dhe ndikimet e jashtme në vendimmarrje, funksionimin e sistemeve elektronike dhe të e-Inspektimit, cilësinë dhe sigurinë e informacionit, administrimin dhe gjurmueshmërinë e dokumentacionit, kufizimet buxhetore, kapacitetet profesionale dhe vijimësinë e proceseve të punës**.

Veçanërisht të rëndësishme janë risqet që mund të ndikojnë në **paanshmërinë e vendimmarrjes, respektimin e kërkesave ligjore, mbrojtjen e informacionit, cilësinë e të dhënave dhe dokumentacionit, si dhe në ushtrimin e rregullt dhe të pandërprerë të funksioneve institucionale**. Për këtë arsye, menaxhimi i tyre kërkon forcimin e mekanizmave ekzistues të kontrollit dhe zbatimin e masave të përshtatshme parandaluese dhe korrigjuese.

Masat e përcaktuara synojnë kryesisht **forcimin e kontroleve të brendshme, përmirësimin dhe standardizimin e procedurave, monitorimin e zbatimit të detyrimeve dhe afateve, rritjen e gjurmueshmërisë dhe cilësisë së dokumentacionit, përmirësimin e sistemeve dhe administrimit të informacionit, zhvillimin e kapaciteteve profesionale, si dhe forcimin e transparencës, komunikimit dhe koordinimit institucional**.

Në këtë kuadër, vlerësimi i riskut të integritetit përbën një instrument për identifikimin e fushave që kërkojnë vëmendje dhe ndërhyrje të prioritizuar, me synim **parandalimin e cenimeve të integritetit, uljen e ekspozimit ndaj riskut dhe forcimin e kulturës së integritetit në ISHTI**.

2. QËLLIMI, FUSHA DHE BAZA E RAPORTIT

Ky raport synon të evidentojë dhe vlerësojë risqet e integritetit në ISHTL, në lidhje me fushat kryesore të veprimtarisë dhe proceset institucionale, si dhe të përcaktojë masat për parandalimin dhe menaxhimin e tyre.

Vlerësimi përfshin fushat e çështjeve juridike dhe prokurimeve publike, buxhetit dhe financës, trajtimit të aksidenteve dhe mbikëqyrjes, analizës dhe monitorimit të riskut, informimit publik dhe koordinimit ndërinstitucional, si dhe burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse.

Raporti mbështetet në vlerësimin e proceseve të punës, identifikimin e faktorëve të riskut, vlerësimin e probabilitetit dhe ndikimit të tyre, si dhe në përcaktimin e masave të nevojshme për trajtimin dhe reduktimin e ekspozimit ndaj riskut të integritetit.

3. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT

Vlerësimi i riskut të integritetit bazohet në metodologjinë e vlerësimit të riskut të integritetit për institucionet publike dhe mbështetet në dy komponentë: **probabilitetin e shfaqjes së riskut dhe ndikimin e tij**. Të dy komponentët vlerësohen në shkallën 1–3, ndërsa niveli i riskut përcaktohet nëpërmjet produktit të tyre: **Niveli i riskut = Probabiliteti × Ndikimi**.

Në bazë të këtij vlerësimi përcaktohet niveli i ekspozimit të institucionit ndaj risqeve të integritetit dhe prioritetizohen fushat që kërkojnë masa për parandalimin dhe menaxhimin e tyre.

Vlera	Probabiliteti / ndikimi	Interpretimi institucional
1	I ulët	Risk i rrallë ose me ndikim të kufizuar.
2	I moderuar / i mesëm	Risk real që mund të menaxhohet përmes kontrolleve të brendshme.
3	I lartë	Risk me probabilitet ose ndikim të lartë, me rëndësi për integritetin, ligjshmërinë, reputacionin ose performancën.

Probabiliteti \ Ndikimi	1 – i ulët	2 – i moderuar	3 – i lartë
1 – i ulët	1	2	3
2 – i moderuar	2	4	6
3 – i lartë	3	6	9

4. FUSHAT E VEPRIMTARISË TË PËRFSHIRA NË VLERËSIMIN INSTITUCIONAL

Fusha e Veprimtarisë	Proceset kryesore të mbuluara
Çështje juridike dhe prokurime publike	Përfaqësimi gjyqësor, proceset gjyqësore/administrative, ekzekutimi i vendimeve dhe detyrimeve, kontratat dhe prokurimi publik, dokumentacioni juridik dhe harmonizimi i akteve.
Buxhet dhe financë	Planifikimi dhe monitorimi i buxhetit, administrimi i të ardhurave/shpenzimeve, raportimi financiar, detyrimet financiare dhe zbatimi i legjislacionit financiar.
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Trajtimi dhe dokumentimi i aksidenteve, analiza e ngjarjeve/shkaqeve/pasojave dhe mbikëqyrja e stafit me rol inspektues.
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Analiza e veprimtarisë inspektuese, vlerësimi i riskut, monitorimi i planeve, të dhënat statistikore, treguesit e performancës, rekomandimet dhe analiza e e-Inspektimit.
Informim publik dhe koordinim ndërinstitutional	Administrimi i kërkesave për informacion, transparencë, komunikimi institucional, koordinimi me institucionet dhe subjektet e interesuara, raportimi dhe cilësia e informacionit publik.
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Marrëdhëniet e punës, dosjet e personelit, procedurat administrative, protokolli/arkiva, asetet dhe shërbimet mbështetëse, etika, disiplina dhe nevojat logjistike.

5. VLERËSIMI I NIVELIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT

Fusha e veprimtarisë	Nr. risqeve	I lartë	I moderuar	I ulët
Juridike dhe prokurime publike	9	2	5	2
Buxhet dhe financë	12	4	8	0
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	9	5	4	0
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	10	5	3	2
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	6	3	3	0
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	15	5	7	3

✚ *Vlerat e mësipërme janë nxjerrë nga tabelat e vlerësimit të risqeve në materialet burimore.*

6. REGJISTRI I RISKUT TË INTEGRITETIT TË ISHTI-t

Regjistri paraqet në nivel institucional risqet e identifikuar në kuadër të vlerësimit të integritetit, të evidentuara sipas fushave dhe proceseve përkatëse të veprimtarisë së ISHTI-t. Klasifikimi sipas fushës pasqyron procesin ose veprimtarinë ku lidhet risku dhe nuk përfaqëson një vlerësim të veçantë të strukturave organizative.

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
Juridike dhe prokurime publike	Konflikt interesi në prokurime ose në çështje juridike	2	3	6	I lartë

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
Juridike dhe prokurime publike	Vonesa në ndjekjen e proceseve gjyqësore dhe përbarimore	1	2	2	I ulët
Juridike dhe prokurime publike	Mos respektimi i procedurave për prokurimin publik.	2	2	4	I moderuar
Juridike dhe prokurime publike	Humbje ose administrimin i pa plotë i dosjeve juridike	2	2	4	I moderuar
Juridike dhe prokurime publike	Mos arkëtimi i detyrimeve.	2	3	6	I lartë
Juridike dhe prokurime publike	Hartim i pa saktë i akteve juridike.	2	2	4	I moderuar
Juridike dhe prokurime publike	Ndikimi i jashtëm në vendimarrje juridike ose prokurimeve	2	2	4	I moderuar
Juridike dhe prokurime publike	Mungesa e trajnimeve të stafit	2	2	4	I moderuar
Juridike dhe prokurime publike	Mosrespektimi i afateve procedurale	1	2	2	I ulët
Buxhet dhe financë	Ndryshime të shpeshta të legjislacionit financiar dhe buxhetor	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Kufizime në mbulimin e nevojave institucionale në	2	3	6	I lartë

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
	kuadër të fondeve buxhetore të miratuara				
Buxhet dhe financë	Afate të kufizuara për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Mosfunksionim ose ndërprerje e sistemeve elektronike shtetërore	2	3	6	I lartë
Buxhet dhe financë	Vonesa në shkëmbimin e informacionit me institucione të tjera publike	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Dorëzimi jo në kohë ose i paplotë i dokumentacionit administrativ dhe financiar	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Mungesë koordinimi ose komunikimi jo i plotë ndërmjet strukturave organizative	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Pajisje informatike të amortizuara	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Mungesë e mekanizmave rezervë për ruajtjen e informacionit	2	3	6	I lartë

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
Buxhet dhe financë	Gabime njerëzore si rezultat i vullmit të lartë të proceseve	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Nevoja për përditësim të vazhdueshëm të njohurive profesionale	2	2	4	I moderuar
Buxhet dhe financë	Procedura administrative dhe financiare që kërkojnë verifikime shtesë	3	2	6	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Ndikime të jashtme në trajtimin e Aksidenteve apo mbikëqyrjet në stafin Inspektues.	3	3	9	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Vonesa në trajtimin dhe administrimin e dosjeve të aksidenteve.	2	3	6	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Dokumentacion jo i plotë ose i pasaktë në dosjet e aksidenteve	2	3	6	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Probleme teknike në programet kompjuterike të administrimit të rasteve	2	2	4	I moderuar
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Mungesa e koordinimit ndërmjet strukturave	2	2	4	I moderuar

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Mungesë mbikëqyrjeje të stafit me rol inspektues	2	2	4	I moderuar
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Mosrespektimi i afateve procedurale	1	2	4	I moderuar
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Konflikt Interesi	2	3	6	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Mosruajtja e konfidencialitetit të dokumentacionit dhe të të dhënave	2	3	6	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Probleme në sistemin e-Inspektimi	3	3	9	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Mungesë cilësie të të dhënave	3	3	9	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Ndryshime në legjislacion	3	3	9	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Mungesë metodologjie standarde	2	3	6	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Moszbatim i rekomandimeve	2	3	6	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Vonesa në raportime	2	2	4	I moderuar
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Komunikim joefektiv	2	2	4	I moderuar
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Mungesë trajnimesh	2	2	4	I moderuar

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Gabime statistikore	1	2	2	I ulët
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Mosrespektim afatesh	1	2	2	I ulët
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Mosrespektimi i afateve ligjore për trajtimin e kërkesave për informim	2	3	6	I lartë
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Publikimi i paplotë ose i pasaktë i informacionit publik	2	3	6	I lartë
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Mungesa e koordinimit me strukturat e tjera të institucionit ose institucionet partnere	2	2	4	I moderuar
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Keqpërdorimi ose rrjedhja e informacionit zyrtar	2	3	6	I lartë
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Mungesa e monitorimit të zbatimit të detyrave	2	2	4	I moderuar
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Mungesa e trajnimeve për etikën dhe integritetin	2	2	4	I moderuar
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Ndryshime në ligjin e inspektimit dhe aktet nënligjore lidhur me	3	3	9	I lartë

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
	marrëdhëniet e punësimit dhe kriteret për emërimin dhe klasifikimin e inspektorëve				
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Kufizime buxhetore	3	3	9	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Probleme teknike në sistemin e-Inspektimi	2	3	6	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Paqartësitë në interpretimin e akteve nënligjore	2	3	6	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Amortizimi i pajisjeve IT	2	3	6	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Mungesa e standardizimit të praktikave administrative	2	2	4	I moderuar
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Komunikimi joefektiv ndërmjet strukturave	2	2	4	I moderuar
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Mungesa e trajnimeve të stafit	2	2	4	I moderuar
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Lëvizjet e shpeshta të personelit	2	2	4	I moderuar
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Mungesa e ambienteve të përshtatshme të punës	2	2	4	I moderuar

Fusha e veprimtarisë	Risku i identifikuar	Probabiliteti	Ndikimi	Rezultati	Niveli
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Vështirësitë në sistemimin, inventarizimin dhe dorëzimin e dokumentacionit arkivor	2	2	4	I moderuar
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Ndërprerjet e sistemeve elektronike	2	2	4	I moderuar
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Mosrespektimi i afateve procedurale	1	2	2	I ulët
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Ndarje e paqartë e përgjegjësi	1	2	2	I ulët
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Dokumentacion jo i plotë i personelit	1	2	2	I ulët

7. FUSHAT KRYESORE TË RISKUT TË INTEGRITETIT NË NIVEL INSTITUCIONAL

Risqet e integritetit të identifikuar në nivel institucional lidhen me fusha të ndryshme të veprimtarisë së ISHTI-t dhe, për shkak të natyrës së tyre, në disa raste shtrihen në më shumë se një proces. Konsolidimi tematik i tyre evidenton çështjet kryesore që ndikojnë në ligjshmërinë, paanshmërinë, transparencën, efektivitetin dhe vijimësinë e veprimtarisë institucionale.

7.1. Çështjet juridike dhe prokurimet publike

Risqet në këtë fushë lidhen me ndryshimet dhe paqartësitë në kuadrin ligjor e rregullator, zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, respektimin e afateve dhe procedurave, si dhe me zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. Në këtë kuadër, ekspozimi ndaj konfliktit të interesit, mungesa e qartësisë procedurale dhe nevoja për përditësim të vazhdueshëm të akteve dhe praktikave mund të ndikojnë në ligjshmërinë dhe integritetin e proceseve institucionale.

7.2. Buxheti dhe financa

Risqet në fushën financiare lidhen me kufizimet buxhetore, planifikimin dhe administrimin e fondeve, dokumentacionin financiar, rakordimet dhe përdorimin e sistemeve elektronike financiare. Këta faktorë mund të ndikojnë në administrimin e rregullt të burimeve dhe në realizimin në kohë të nevojave financiare dhe operative të institucionit.

7.3. Trajtimi i aksidenteve dhe mbikëqyrja

Kjo fushë përfshin risqe që lidhen me ushtrimin e funksioneve të mbikëqyrjes dhe trajtimin e rasteve të aksidenteve, përfshirë paanshmërinë në vendimmarrje, konfliktin e interesit, ndikimet e jashtme, respektimin e procedurave dhe afateve, si dhe cilësinë dhe gjurmueshmërinë e dokumentacionit. Natyra e këtyre proceseve e bën veçanërisht të rëndësishëm garantimin e objektivitetit dhe integritetit në vendimmarrje.

7.4. Analiza, vlerësimi i riskut dhe monitorimi

Risqet lidhen me cilësinë dhe plotësinë e informacionit, monitorimin e proceseve, analizën dhe vlerësimin e risqeve, si dhe me përdorimin e të dhënave për marrjen e vendimeve. Dobësitë në këto procese mund të ndikojnë në identifikimin në kohë të problematikave dhe në efektivitetin e masave të kontrollit dhe monitorimit.

7.5. Informimi publik dhe koordinimi ndërinstytucional

Në këtë fushë evidentohen risqe që lidhen me komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit, transparencën, koordinimin me institucionet e tjera dhe respektimin e afateve në përcjelljen e të dhënave dhe përgjigjeve. Efektiviteti i këtyre proceseve ndikon në transparencën, bashkëpunimin institucional dhe cilësinë e shërbimit publik.

7.6. Burimet njerëzore dhe shërbimet mbështetëse

Risqet lidhen me kapacitetet profesionale, nevojën për trajnime dhe përditësim të njohurive, lëvizjet e personelit, transferimin e njohurive, përcaktimin e qartë të përgjegjësisë dhe vijimësinë e funksioneve mbështetëse. Këta faktorë mund të ndikojnë në kapacitetin institucional për përmbushjen e detyrave dhe në qëndrueshmërinë e proceseve.

Në tërësi, risqet e mësipërme paraqesin një ekspozim të ndërlidhur institucional, ku faktorët juridikë, financiarë, operacionalë, njerëzorë dhe të komunikimit ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në integritetin dhe efektivitetin e veprimtarisë së ISHTI-t.

7. RISQET ME PRIORITET TË LARTË NË NIVEL ISHTI

Fusha e veprimtarisë	Risku	P	I	Rez.	Niveli
Juridike dhe prokurime publike	Konflikt i interesi në prokurime ose në çështje juridike	2	3	6	I lartë
Juridike dhe prokurime publike	Mos arkëtimi i detyrimeve.	2	3	6	I lartë
Buxhet dhe financë	Kufizime në mbulimin e nevojave institucionale në kuadër të fondeve buxhetore të miratuara	2	3	6	I lartë
Buxhet dhe financë	Mosfunksionim ose ndërprerje e sistemeve elektronike shtetërore	2	3	6	I lartë
Buxhet dhe financë	Mungesë e mekanizmave rezervë për ruajtjen e informacionit	2	3	6	I lartë
Buxhet dhe financë	Procedura administrative dhe financiare që kërkojnë verifikime shtesë	3	2	6	I lartë

Fusha e veprimtarisë	Risku	P	I	Rez.	Niveli
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Ndikime të jashtme në trajtimin e Aksidenteve apo mbikëqyrjet në stafin Inspektues.	3	3	9	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Vonesa në trajtimin dhe administrimin e dosjeve të aksidenteve.	2	3	6	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Dokumentacion jo i plotë ose i pasaktë në dosjet e aksidenteve	2	3	6	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Konflikt Interesi	2	3	6	I lartë
Trajtim aksidentesh dhe mbikëqyrje	Mosruajtja e konfidencialitetit të dokumentacionit dhe të të dhënave	2	3	6	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Probleme në sistemin e-Inspektimi	3	3	9	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Mungesë cilësie të të dhënave	3	3	9	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Ndryshime në legjislacion	3	3	9	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Mungesë metodologjie standarde	2	3	6	I lartë
Analizë, vlerësim risku dhe monitorim	Moszbatim i rekomandimeve	2	3	6	I lartë

Fusha e veprimtarisë	Risiko	P	I	Rez.	Niveli
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Mosrespektimi i afateve ligjore për trajtimin e kërkesave për informim	2	3	6	I lartë
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Publikimi i paplotë ose i pasaktë i informacionit publik	2	3	6	I lartë
Informim publik dhe koordinim ndërinstitucional	Keqpërdorimi ose rrjedhja e informacionit zyrtar	2	3	6	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Ndryshime në ligjin e inspektimit dhe aktet nënligjore lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe kriteret për emërimin dhe klasifikimin e inspektorëve	3	3	9	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Kufizime buxhetore	3	3	9	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Probleme teknike në sistemin e-Inspektimi	2	3	6	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Paqartësitë në interpretimin e akteve nënligjore	2	3	6	I lartë
Burime njerëzore dhe shërbime mbështetëse	Amortizimi i pajisjeve IT	2	3	6	I lartë

8. MEKANIZMAT EKZISTUES TË KONTROLLIT

ISHTI disponon një sërë mekanizmesh ekzistues kontrolli. Në nivel institucional, këta mekanizma mund të konsolidohen në grupet e mëposhtme:

Mekanizmi	Elementet kryesore të kontrollit
Kontrolli ligjor dhe hierarkik	Monitorimi i ndryshimeve ligjore; konsultimi juridik; shqyrtimi dhe miratimi hierarkik i akteve.
Konflikti i interesit dhe etika	Deklarimi i konfliktit të interesit; zbatimi i Kodit të Etikës; kontrolli nga drejtuesit; kufizimi i ndikimeve të jashtme.
Kontrolli i dokumentacionit	Verifikimi paraprak; kontrolli i dytë; listat e verifikimit; regjistrimi dhe arkivimi; inventarizimi dhe kontrolllet periodike.
Kontrolli i sistemeve dhe informacionit	Mbështetje teknike; raportim i problematikave; backup; kontroll aksesi; monitorim i sistemeve; procedura alternative kur është e mundur.
Monitorimi dhe raportimi	Raporte periodike; monitorim i afateve; ndjekje e rekomandimeve; tregues performance; rakordime dhe evidencia elektronike.
Burimet njerëzore dhe kapacitetet	Trajnime; planifikim i nevojave; procedura dorëzimi; transferim njohurish; përditësim i përshkrimeve dhe roleve, rishikimi i procedurave; informimi i stafit.
Koordinimi institucional	Komunikim zyrtar; takime koordinuese; shkëmbim informacioni ndërmjet strukturave dhe me institucionet e tjera.

9. PLANI I MASAVE PËR MENAXHIMIN E RISKUT

Fusha e masës	Masa institucionale	Prioriteti	Përgjegjësia / afati	Kosto
Kuadri ligjor dhe procedurat	Monitorim i vazhdueshëm i ndryshimeve ligjore; analizë e akteve të reja; përditësim i procedurave informim/trajnim i stafit.	I lartë	Strukturat përgjegjëse sipas fushës; në vazhdimësi / brenda afatit të përcaktuar nga ndryshimi.	Kryesisht pa kosto shtesë
Konflikti i interesit dhe ndikimet e jashtme	Forcim i deklarimit dhe kontrollit të konfliktit të interesit; zbatim i Kodit të Etikës; kontroll hierarkik i vendimmarrjes.	I lartë	Drejtnesit e strukturave dhe strukturat përgjegjëse; monitorim i vazhdueshëm.	Pa kosto shtesë
Dokumentacioni dhe arkivimi	Verifikim i dokumentacionit; kontroll i dytë; standardizim; sistemim dhe inventarizim i arkivës; gjurmueshmëri.	I lartë / i moderuar sipas procesit	Strukturat që administrojnë dokumentacionin; në vazhdimësi.	Kryesisht pa kosto shtesë
e-Inspektimi dhe sistemet elektronike	Raportim defektesh; koordinim me administratorët; backup; testim rikuperimi; procedura alternative; përmirësim i pajisjeve.	I lartë	Strukturat përgjegjëse për IT dhe strukturat përdoruese; në vazhdimësi.	Mund të kërkojë fonde

Fusha e masës	Masa institucionale	Prioriteti	Përgjegjësia / afati	Kosto
Cilësia e të dhënave dhe analizave	Verifikim i të dhënave; kontrolle cilësie; krahasim me burimet primare; auditim periodik; kontroll i dyfishtë i analizave.	I lartë	Strukturat analizuuese dhe përgjegjësit e proceseve; periodikisht.	Kryesisht pa kosto shtesë
Buxheti dhe planifikimi financiar	Monitorim i realizimit të buxhetit; planifikim dhe priorizim i nevojave; përcjellje e kërkesave për fonde; kontroll i dokumentacionit financiar.	I lartë	Struktura financiare dhe strukturat kërkuese; çdo vit dhe periodikisht.	Kryesisht pa kosto shtesë
Koordinimi dhe komunikimi	Përcaktim i kanaleve të komunikimit; takime periodike; shkëmbim në kohë i informacionit; ndjekje e detyrave.	I moderuar / i lartë sipas riskut	Drejtuësit dhe strukturat përkatëse; periodikisht.	Pa kosto shtesë
Afatet dhe raportimi	Evidentim i afateve; monitorim periodik; raportim mujor/periodik; marrje masash korrigjuese kur konstatohen vonesa.	I lartë	Përgjegjësit e proceseve dhe drejtuesit; në vazhdimësi.	Pa kosto shtesë
Kapacitetet profesionale	Identifikim i nevojave; plan vjetor trajnimesh; trajnime mbi procedurat, etikën, integritetin dhe fushat profesionale.	I moderuar / i lartë sipas riskut	Burimet njerëzore dhe drejtuesit; vjetor dhe periodik.	Sipas planit të trajnimeve
Vijimësia dhe transferimi i njohurive	Dokumentim i proceseve; dorëzim detyrë; transferim	I moderuar	Burimet njerëzore dhe drejtuesit; në vazhdimësi.	Pa kosto shtesë

Fusha e masës	Masa institucionale	Prioriteti	Përgjegjësia / afati	Kosto
	njohuri; ruajtje e praktikave të punës.			
Kushtet dhe pajisjet e punës	Evidencim i nevojave; plan zëvendësimi; optimizim i ambienteve; kërkesa për fonde sipas planit të investimeve.	I moderuar / i lartë	Strukturat mbështetëse dhe përgjegjësit teknikë; sipas planifikimit buxhetor.	Mund të kërkojë fonde

10. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Materialet burimore parashikojnë monitorim periodik përmes raporteve 6-mujore dhe vjetore nga Grupi i Punës për Integritetin, nën monitorimin e Koordinatorit të Integritetit në ISHTI. Në raportimin institucional duhet të përfshihen statusi i zbatimit të masave, problematikat e evidentuara, rekomandimet për përmirësim dhe vlerësimi i efektivitetit të masave.

Elementi i monitorimit	Përmbajtja e rekomanduar
Statusi i masave	Masat e realizuara, në proces dhe të parealizuara.
Ecuria e risqeve	Ndryshimi i probabilitetit/ndikimit dhe risqet e reja të shfaqura.
Kontrollet	Vlerësimi nëse mekanizmat ekzistues funksionojnë dhe nëse kërkojnë forcim.
Problematikat	Shkaqet e vonesave, pengesat organizative, teknike, ligjore ose financiare.
Efektiviteti	Vlerësimi i ndikimit real të masave në uljen e ekspozimit ndaj riskut.
Përditësimi	Rishikimi i regjistrit dhe planit të masave në bazë të rezultateve të monitorimit.

11. KONKLUZIONE

Vlerësimi i riskut të integritetit tregon se ekspozimi i ISHTI-t shtrihet në disa fusha të veprimitarisë institucionale, përfshirë çështjet juridike dhe prokurimet publike, buxhetin dhe financën, trajtimin e aksidenteve dhe mbikëqyrjen, analizën dhe monitorimin, informimin publik dhe koordinimin ndërinstitucional, si dhe burimet njerëzore dhe shërbimet mbështetëse. Për rrjedhojë, menaxhimi i riskut të integritetit kërkon një qasje të koordinuar dhe angazhim institucional.

Prioritet në trajtimin e risqeve duhet t'u jepet risqeve të vlerësuara me nivel **6 dhe 9**, veçanërisht atyre që shfaqen në më shumë se një proces ose fushë të veprimitarisë, si ndryshimet dhe interpretimi i kuadrit ligjor, konfliktet e interesit dhe ndikimet e jashtme, funksionimi i sistemeve elektronike, cilësia dhe siguria e informacionit, kufizimet buxhetore, si dhe administrimi i dokumentacionit dhe gjurmueshmëria.

Trajtimi i risqeve kërkon forcimin e kontrolleve të brendshme, standardizimin dhe përditësimin e procedurave, respektimin dhe monitorimin e afateve, përmirësimin e dokumentimit dhe gjurmueshmërisë, zhvillimin e kapaciteteve profesionale, forcimin e komunikimit dhe koordinimit, si dhe garantimin e vijimësisë së sistemeve dhe proceseve institucionale.

Rezultatet e vlerësimit përbëjnë një bazë për përcaktimin e prioritetëve dhe masave në kuadër të Planit të Integritetit të ISHTI-t. Zbatimi dhe monitorimi i këtyre masave kërkon angazhim të strukturave përgjegjëse, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara për secilën fushë të veprimitarisë.

12. REKOMANDIME PËR TRAJTIMIN DHE MONITORIMIN E RISQEVE

Zbatimi i rekomandimeve do të harmonizohet me Programin e Miratuar të Punës për Grupin e Integritetit dhe do të ndiqet përmes mekanizmave institucionalë të monitorimit.

Ecuria dhe efektiviteti i masave do të vlerësohen periodikisht, duke mundësuar përshtatjen e tyre sipas nevojave dhe risqeve të identifikuara.

PËRGATITI:

Anëtare e Grupit të Punës për Integritetin

Migena BODLLI

Përgatitja dhe konsolidimi i Raportit të Vlerësimit të Riskut të Integritetit të ISHTI-t

Nënshkrimi: _____

Data: 13 / 08 / 2026

SHQYRTUAR DHE KONFIRMUAR NGA:

Koordinatori i Grupit të Punës për Integritetin

Suela META

Nënshkrimi: _____

Data: 13 / 08 / 2026

MIRATOI

KRYEINSPEKTOR

SOKOL ZAIMI

Data: 14 / 08 / 2026

